



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1.4, nenin 46 paragrafi 2.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 29.06.2017 merr:

V E N D I M

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit autorizon Kryetarin e Komunës që të kërkojë nga Ministritë përkatëse dhe Qeveria e Kosovës mbulimin e shpenzimeve për disa obligime të pa planifikuara që ka Komuna e Gjilanit, e që kanë të bëjnë me:
 - 1.1 Pagesën e borxhit të TV Valit i cili ka bërë transmetim të seancave të Kuvendit edhe pse nuk ka pas kontratë,
 - 1.2 Pagesën e këshillave të fshatrave,
 - 1.3 Pagesën e borxhit ndaj Eco-Higjena – SHPK Gjilan
2. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Kryetari i Komunës, përderisa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesja e KK-Gjilan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr. 16-64758
Gjilan, më 29.06.2017

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi